




Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË KOSOVËS 2023 – 2026



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# **STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË KOSOVËS 2023 – 2026**

Prishtinë, dhjetor 2023

## Tabela e përmbajtjes

Fjala e Auditorës së Përgjithshme .....	1
Akronimet.....	2
1.Hyrje .....	3
2.Vizioni, misioni dhe vlerat e ZKA-së.....	4
3.Parimet e komunikimit të ZKA-së .....	5
4.Palët e interesit .....	6
5.Qëllimi i komunikimit .....	9
6.Qëllimet strategjike të komunikimit .....	10
7.Mjetet dhe kanalet e komunikimit .....	13
8.Rolet dhe përgjegjësitë .....	13
9.Zbatimi, raportimi dhe vlerësimi .....	15

# FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME



Komunikimi efektiv është pjesë përbërëse e suksesit të misionit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për të promovuar transparencën, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë në menaxhimin e financave publike.

Krahas ndryshimeve dhe zhvillimeve të shpejta teknologjike si dhe intensitetit të rritur të komunikimit, përgjegjësia jonë për të komunikuar me publikun dhe palët e interesit, si dhe për të shpërndarë informacionin në kohë, është më e rëndësishme se kurrë.

Qëllimet kryesore të Strategjisë së Komunikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës 2023 – 2026 i shërbejnë rritjes së bashkëpunimit dhe transparencës përmes të cilave ne synojmë të nxisim komunikimin në mënyrë proaktive me publikun dhe palët e interesit, lidhur me rezultatet e punës tonë, përkatësisht gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.

Si Auditore e Përgjithshme, ftoj kolegët e mi dhe palët e jashtme që të marrin pjesë aktive në bashkëpunimet tona për zbatimin e kësaj Strategjie të Komunikimit. Kam besim të plotë se përmes kësaj Strategjie të Komunikimit ne do të kontribuojmë dhe do të forcojmë besimin e publikut në institucionin tonë, duke i shërbyer qëllimit tonë të përbashkët për një administratë publike më të përgjegjshme dhe transparente.

Vlora Spanca  
Auditore e Përgjithshme e Kosovës

*Prishtinë, dhjetor 2023*

# AKRONIMET

<b>AP</b>	Auditorja e Përgjithshme
<b>EUROSAI</b>	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>GJEA</b>	Gjykata Evropiane e Auditorëve
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISA</b>	Institucionet Supreme të Auditimit
<b>KBPT</b>	Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
<b>KISP</b>	Korniza e INTOSAI-t për Standardet Profesionale
<b>KMFP</b>	Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
<b>NP</b>	Ndërmarrjet Publike
<b>OB</b>	Organizatrat Buxhetore
<b>OSHC</b>	Organizatrat e Shoqërisë Civile
<b>SNISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ZKAK</b>	Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës

# 1. HYRJE

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, që sipas Kushtetutës dhe kornizës ligjore në fuqi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) e ndihmon Auditorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit të Kosovës dhe ka të drejtën të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative e të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë proceset dhe të ardhurat nga shitja e pasurive, privatizimi dhe koncesionet, në pajtim me legjislacionin vendor dhe Kornizën e INTOSAI-t për Standardet Profesionale (KISP).

ZKA-ja e njej rëndësinë e ofrimit të informacionit te Kuvendi dhe publiku rreth mënyrës se si Qeveria i menaxhon burimet shtetërore. Prandaj, strategjia e komunikimit e një Institucioni Suprem të Auditimit është një mjet thelbësor për promovimin e praktikave më të mira, llogaridhënies dhe transparencës për aktivitetet e institucioneve publike. Bashkëpunimi me palët e interesit dhe partnerët tjerë është prioritet strategjik i ZKA-së. Përmes avancimit të komunikimit dhe rritjes së bashkëpunimit me palët e interesit, synon të krijoj ambient të përshtatshëm që i kontribuon komunikimit në mënyrë efektive dhe efikase.

Duke e konsideruar komunikimin si vlerë vitale të institucionit, ZKA-ja ndjek qasje strategjike për qëllimet dhe objektivat e përcaktuara për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm. Përveç kërkesave ligjore, ZKA-ja mbështet qasjen e saj strategjike në parimet fundamentale të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, sikurse Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës. Për t'i kontribuar transparencës në nivel institucional dhe me gjerë, ZKA-ja fokusohet në avancimin e vazhdueshëm të proceseve dhe komunikimit të brendshëm, për të qenë në gjendje të rris ndikimin e punës së vet dhe të bëjë ndryshimin në jetën e qytetarëve.

Për të arritur qëllimet e synuara me Strategjinë e Komunikimit 2023 - 2026, do të hartohet plani i veprimit, raportimit dhe monitorimit të zbatimit të saj. Po ashtu, duhet përmendur se zbatimi i saj adreson kërkesat sipas objektivës 1 "Rritja e ndikimit të ZKA-së përmes komunikimit efektiv me palët e jashtme" të qëllimit 3 "Imazhi dhe ndikimi" të Planit Strategjik të Zyrës Kombëtare të Auditimit 2023 - 2026.

## 2. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT E ZKA-SË

### VIZIONI

“Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike ”

### MISIONI

“Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e llogaridhënies publike ”

### VLERAT

#### Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

#### Integriteti

ZKA-ja angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

#### Profesionalizmi

ZKA-ja udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA/INTOSAI dhe nga praktikat e mira të vendeve tjera.

#### Transparenca

ZKA-ja është organizatë e hapur dhe do t'i bëj publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofroj publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA-ja angazhohet që të promovoj transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

#### Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunues në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

## 3. PARIMET E KOMUNIKIMIT TË ZKA-SË

### I bazuar në fakte dhe dëshmi

Produktet e ZKA-së janë rezultat i procesit të saj të auditimit të kryer me profesionalizëm, bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit përfshirë kontrollin dhe sigurimin e cilësisë.

### I qartë

ZKA-ja komunikon mesazhin e saj në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për palët e interesit.

### Me kohë

Mesazhi i ZKA-së i përgjigjet nevojave dhe afateve të përcaktuara nga korniza ligjore, si dhe bazuar në rrethanat dhe kërkesat e palëve të interesit.

### Me angazhim

ZKA-ja inkurajon palët e interesit të ofrojnë informata dhe të përdorin produktet e saj për qëllimet e tyre dhe për interesin publik.

### Gjithëpërfshirës

Ndarja e informatave në atë mënyrë që secili mund ta kuptojë - me respekt, i saktë dhe gjithëpërfshirës, duke i mundësuar secilit të kontribuojë në perspektiva të ndryshme dhe të ndjehet pjesëmarrës.



## 4. PALËT E INTERESIT

Angazhimi i ZKA-së me partnerët strategjikë dhe palët e interesit<sup>1</sup> është konstruktiv. Megjithatë, komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me palët e interesit i ndihmon ZKA-së për t'i ofruar publikut njohuri më të mira për rolin dhe mandatin e saj si dhe adresimin e pritshmërive të tyre.

Bashkëpunimi me Legjislativin dhe Ekzekutivin, inkurajon zbatimin e ligjit dhe lehtëson mbikëqyrjen dhe llogaridhënien publike. Po ashtu, ZKA-ja ruan bashkëpunim të mirë edhe me median dhe shoqërinë civile për të siguruar se qytetarët informohen me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.

Për të arritur nivelin e dëshiruar të ndikimit dhe promovimit të punës së saj, ZKA-ja palë kryesore interesi ka punonjësit e saj me të cilët zhvillon komunikim aktiv të bazuar në parimin e mirëkuptimit.

Palët e interesit janë:

- *Kuvendi dhe komisionet parlamentare;*
- *Ministritë, agjencitë, komunat, NP-të dhe entitetet e tjera publike të audituara;*
- *Punonjësit e ZKA-së;*
- *Qytetarët e Kosovës;*
- *Mediat;*
- *OShC-të;*
- *Donatorët;*
- *Akademia dhe shoqatat profesionale; dhe*
- *Partnerët ndërkombëtarë (INTOSAI, EUROSAI dhe organizata të tjera).*

---

<sup>1</sup> INTOSAI-P12 (Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA-ve), sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve) e përcakton palën e interesit si një person, grup, organizatë, anëtar ose sistem, i cili mund të ndikojë ose të ndikohet nga veprimet, objektivat dhe politikat e Qeverisë dhe entiteteve publike


Tabela në vijim paraqet pritshmëritë kryesore nga angazhimi i ZKA-së me palët e interesit:

**Tabela 1. Palët e interesit dhe pritshmëritë nga bashkëpunimi me to:**

Pala e interesit	Pritshmëritë
1. Kuvendi dhe komisionet parlamentare	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbikëqyrja e ligjshmërisë së shpenzimeve të parasë publike bazuar në raportet e auditimit të ZKA-së;</li> <li>Shqyrtimi i nevojave të ZKA-së për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj;</li> <li>Mbështetja dhe mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit;</li> <li>Përdorimi i mandatit dhe kompetencës si një mjet për të inkurajuar dhe rritur transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë në menaxhimin e financave publike.</li> </ul>
2. Ministritë, agjencitë, komunat, NP-të dhe entitetet e tjera publike të audituara	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ofrimi i sigurisë për pasqyrat financiare dhe menaxhimin financiar;</li> <li>Ofrimi i kushteve të punës dhe përgjigjja në kohë në kërkesat e ZKA-së gjatë ekzekutimit të auditimit;</li> <li>Zotimi dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit.</li> </ul>
3. Punonjësit e ZKA-së	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i komunikimit dhe bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm me qëllim të përmirësimit dhe promovimit të rezultateve të punës së ZKA-së.</li> </ul>
4. Qytetarët e Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ofrimi i informacionit për nevojat, interesat, dhe pritshmëritë nga ZKA-ja;</li> </ul>
5. Media	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raportimi për rezultatet e auditimit në mënyrë të saktë dhe të paanshme;</li> <li>Promovimi i rolit të ZKA-së në përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe rritjes së llogaridhënies dhe transparencës.</li> </ul>
6. Organizatat e Shoqërisë Civile	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkëpunimi me ZKA-në në iniciativa dhe projekte të ndryshme;</li> <li>Referimi të produktet e ZKA -së në përdorimin e tyre gjatë kryerjes së hulumtimeve;</li> <li>Ofrimi i propozimeve dhe diskutimi me ZKA-në për identifikimin e fushave dhe temave me interes për auditim;</li> <li>Promovimi dhe përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.</li> </ul>

- 
- |   |  |
|---|--|
| 7. Donatorët  | <ul style="list-style-type: none"><li>• Mbështetja në raporte të auditimit të ZKA-së për të siguruar besimin dhe marrë vendime për financime të entiteteve publike të audituara;</li><li>• Mbështetja e ZKA-së në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale;</li><li>• Promovimi i pavarësisë funksionale dhe financiare të ZKA -së.</li></ul> |
| 8. Akademia dhe shoqatat profesionale                                 | <ul style="list-style-type: none"><li>• Mbështetja e ZKA -së në zhvillimin profesional përmes trajnimeve dhe programeve edukative profesionale;</li><li>• Ofrimi i ekspertizës në fusha specifike.</li></ul>   |
| 9. Partnerët ndërkombëtarë (INTOSAI, EUROSAI dhe organizata të tjera) | <ul style="list-style-type: none"><li>• Bashkëpunimi me ZKA-në si një ISA me të drejta të plota në kuadrin botëror, evropian dhe rajonal;</li><li>• Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në aktivitete bilaterale dhe multilaterale me qëllim të shkëmbimit të përvojës profesionale.</li></ul>  |
-

## 5. QËLLIMI I KOMUNIKIMIT



**“ RITJA E NDIKIMIT TË ZKA-SË PËRMES KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME PALËT E INTERESIT ”**

## 6. QËLLIMET STRATEGJIKE TË KOMUNIKIMIT

1.

Promovimi i rolit kushtetues të ZKA-së dhe rritja e ndikimit të rezultateve audituese në sektorin publik.

2.

Komunikim i brendshëm aktiv me qëllim të mbështetjes së punonjësve dhe promovimit të rezultateve të punës.

**Qëllimi 1**

Promovimi i rolit kushtetues të ZKA-së dhe rritja e ndikimit të rezultateve audituese në sektorin publik

	Objektivat strategjike	Treguesit e rezultatit
<p><b>1</b></p>	<p>Promovimi i rezultateve të punës audituese të ZKA-së përmes komunikimit efektiv me palët e jashtme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunimi me palët e interesit (OShC-të, media, donatorët, academia, etj) përmes konferencave, punëtorive dhe formave tjera, i rritur; dhe</li> <li>• Prezenca e punës audituese dhe ZKA-së në media e rritur.</li> </ul>
<p><b>2</b></p>	<p>Rritja e llogaridhënies në menaxhimin e financave publike përmes bashkëpunimit me Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Kuvendet Komunale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetja profesionale ndaj Komisioneve Parlamentare në shqyrtimin e raporteve të auditimit e siguruar;</li> <li>• Komisionet parlamentare angazhohen për rritjen llogaridhënies në menaxhimin e financave publike;</li> <li>• Bashkëpunimi me Kuvendet Komunale i rritur.</li> </ul>
<p><b>3</b></p>	<p>Rritja e bashkëpunimit me organizatat buxhetore për rritjen e ndikimit të punës audituese</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Promovimi i rezultateve të punës audituese dhe ndikimi i mirë nga zbatimi i rekomandimeve të auditimit;</li> <li>• Bashkëpunimi proaktiv me entitetet e audituara për adresimin e rekomandimeve i rritur;</li> <li>• Cilësia e raportimit financiar e rritur;</li> <li>• Përqindja (%) e rekomandimeve të zbatuara e rritur.</li> </ul>

**Qëllimi 2**

Komunikim i brendshëm aktiv me qëllim të mbështetjes së punonjësve dhe promovimit të rezultateve të punës.

	Objektivat strategjike	Treguesit e rezultatit
1	Krijimi hapësirës digjitale për vendosjen dhe ndarjen e informacionit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hapësira digjitale e vendosur dhe vënë në përdorim; dhe</li> <li>Informatat përditësohen dhe shpërndahen me kohë.</li> </ul>
2	Avancimi i komunikimit dhe përcaktimi i përgjegjësive individuale dhe korporative	<ul style="list-style-type: none"> <li>Akti rregullativ për komunikim i hartuar dhe miratuar; dhe</li> <li>Nxitja e komunikimit horizontal dhe vertikal (poshtë – lartë dhe lartë – poshtë).</li> </ul>
3	Rritja e kujdesit për kulturën organizative	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitete të përbashkëta me qëllim socializimin dhe rritjen e frymës ekipore organizohen në vazhdimësi;</li> <li>Aktivitetet profilaktike për stafin të ofruara.</li> </ul>

## 7. MJETET DHE KANALET E KOMUNIKIMIT

Për t'iu përgjigjur kërkesave dhe pritshmërive nga palët e interesit, ZKA-ja rishikon dhe modernizon vazhdimisht qasjen e saj të komunikimit, duke pasur gjithmonë parasysh që reputacioni dhe emri i saj janë ndër pasuritë e saj më me vlerë. ZKA-ja përdorë mjetet dhe kanalet e komunikimit si: konferencat, punëtoritë, takimet, mediat, si dhe platforma dhe aplikacione elektronike, në mënyrë efektive, për të arritur zbatimin e qëllimeve strategjike.

Komunikimi nuk nënkupton vetëm ofrimin e informacionit, por është gjithashtu një proces i ndërsjellë. Prandaj, përveç komunikimit të rezultateve të punës së saj, ZKA-ja i jep rëndësi të veçantë komunikimit të brendshëm për të siguruar se informacioni i duhur është shpërndarë me kohë brenda vet institucionit dhe te palët e jashtme të interesit. Po ashtu, vazhdimisht vëzhgon reagimin e palëve të interesit dhe opinionit publik për t'ju përgjigjur pritjeve të tyre.

## 8. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kjo strategji komunikimi është e zbatueshme për të gjithë punonjësit e ZKA-së, të cilët informohen për rolin, përgjegjësitë dhe obligimin në përmbushjen e saj.

Auditori i Përgjithshëm dhe menaxhmenti i lartë i ZKA-së kanë një rol kyç në zbatimin e Strategjisë së Komunikimit përmes përgjegjësive në vijim:

- *Përcjellja e mesazhit kryesor te palët e interesit lidhur me çështjet që dalin nga auditimi;*
- *Rritja dhe ruajtja e besimit në punën e ZKA-së; dhe*
- *Udhëheqja përmes shembullit lidhur me vlerat e ZKA-së, duke u bërë model për sjelljet dhe qëndrimet që të gjithë punonjësit duhet t'i përvetësojnë.*



Udhëheqësi dhe stafi i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar ka për detyrë të përcjellë mesazhet e ZKA-së në mënyrë efektive dhe profesionale te palët e interesit, duke:

- *Këshilluar se si të arrihet më së miri audiencia e synuar, duke specifikuar formën dhe stilin e mesazhit dhe duke përzgjedhur kohën dhe kanal/et më të përshtatshme;*
- *Menaxhuar marrëdhëniet publike të ZKA-së me palët e interesit përmes faqes së internetit dhe kanaleve të tjera, duke siguruar konsistencë të mesazhit;*
- *Shërbyer si pikë kontakti e ZKA-së dhe duke menaxhuar e koordinuar përgjigjet e ZKA-së ndaj pyetjeve nga jashtë;*
- *Marrë pjesë aktive në zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së ZKA-së për komunikim;*
- *Ruajtur dhe azhurnuar mjetet e komunikimit të ZKA-së, përfshirë faqen zyrtare të internetit, mjetet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.*

Përgjegjësitë kryesore të stafit auditues lidhur me komunikimin janë:

- *Të përçojnë mesazhin për misionin, vizionin dhe vlerat e ZKA-së, duke i demonstruar ato në të gjitha kontaktet dhe angazhimet me palët e jashtme të interesit;*
- *Të mirëmbajë marrëdhënie profesionale me entitetet e audituara, bazuar në respektin e ndërsjellë dhe në njohjen e roleve përkatëse të auditorit dhe të të audituarit;*
- *T'i paraqesin rezultatet e auditimit te Kuvendi dhe palët e tjera të interesit ashtu siç autorizohen nga Auditori i Përgjithshëm dhe sipas kërkesave nga Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.*

## 9. ZBATIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI

Për të arritur synimet dhe objektivat e kësaj strategjie për komunikim, ZKA-ja ka hartuar planin e veprimit për periudhën 2023-2026. Ky plan azhurnohet çdo vit.

Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar do të ketë për detyrë koordinimin dhe zbatimin e këtij plani. Një grup brenda ZKA-së, i përbërë nga Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, Udhëheqësi i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Drejtori i Departamentit për Planifikim Strategjik dhe Raportim, do të mbikëqyrë zbatimin.

Grupi i punës do të raportojë për progresin në zbatimin e planit te Auditori i Përgjithshëm në baza të rregullta vjetore.

Vlerësimi i zbatimit do të kryhet nga një ekip i autorizuar nga Auditori i Përgjithshëm.

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT**

Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

[komunikim@oagks.org](mailto:komunikim@oagks.org)

+383 (0) 38 6060 04 ext. 1012

Ose

+383 (0) 38 6060 04 ext. 1188

Zyra Kombëtare e Auditimit  
Lagjja Arbëria  
Rr. Ahmet Krasniqi, 210  
10000 Prishtina  
Republika e Kosovës

